



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave / Ministry of Internal Affairs and Public Administration

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

14.04.2020

NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE VAZHDON MËSIMI ONLINE

Të nderuar student dhe mësime dhënë të Fakultetit të Sigurisë Publike.

Dëshiroi të ju falënderoi për mësimin nga distanca që jeni duke e mbajtur, në rrethanat e krijuara pas datës 12.03.2020, si rezultat i Pandemisë Covid 19, me ç' rast u ndërpre procesit edukativo-arsimor në institucioneve arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet, në përputhje me Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/07 të datës 11.03.2020. Pas një angazhimi të personelit të Divizionit të Teknologjisë Informative, ky Divizion ka arritur që të bëjë unifikimin e platformës për ndjekjen e mësimin online, me shumicën e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

Mësimi online nga sot zhvillohet në platformat e unifikuara:

Google Meet <https://meet.google.com>

Google Classroom <https://classroom.google.com>

Dekani i Fakultetit të Sigurisë Publike dhe personeli mësime dhënë i mbështetur nga Divizioni i Teknologjisë Informative, kanë ndërmarrë të gjitha masat që mësimi të vazhdoi të zhvillohet në online në platformat e lartcekura.

Sa i përket vazhdimin të moduleve të punës praktike (internshipit) të studentëve, studentët do të vazhdojnë këto module të i zhvillojnë bazuar në platformat e përzgjedhura dhe të marrëveshura nga takimi (përmes platformës SKYPE) të Dekanit të Fakultetit të Sigurisë Publike Zotit Bejtush Gashi, Koordinatorit për Mësim Praktik-INTERNSHIP Zotit Valon Zeqirit dhe Koordinatorëve të Mentorëve të Agjencive të Sigurisë Publike.

Të dashur studentë të Fakultetit të Sigurisë Publike,

Duke mare parasysh që Ju, përveç studentë të Fakultetit të Sigurisë Publike, në të njëjtën kohë jeni punëtor të punësuar në Institucionet e Sigurisë Publike dhe jeni në ballë të luftës të cilën po e bëjnë Institucionet e vendit tonë kundër "Covid 19", më

lejoni të iu përgëzoi për angazhimin tuaj dhe përkushtimin për sigurinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Të nderuar mësimdhënës,

Së bashku me Dekanin e Fakultetit të Sigurisë Publike, më lejoni të iu falënderoi për punën që po bëni dhe përkushtimin tuaj në rrethanat e krijuara dhe të ju dëshiroi shëndet juve dhe familjeve tuaja.

Me shpresa që sa më parë të kthehemi në institucionet tona në rrethana normale të vazhdimin të mësimin, iu dëshiroi suksese në angazhimin tuaj.

Më poshtë po japim disa detaje teknike në lidhje me mësimin online:

Akademia e Kosovës për Siguri Publike njofton të gjithë studentët se janë finalizuar përgatitjet për të vijuar me mësim virtual.

Secilit prej jush i është krijuar e-mail i personalizuar në Google "**G Suite for Education**", në mënyrë që ju të mund të vazhdoni **mësimin online**, pa pengesë, gjatë kohës së masave të marra për evitim të kontaktit fizik.

1. E-mailat janë krijuar në formatin **emri.mbiemri@aksp-ks.org**, ndërsa **fjalëkalimi** juaj do të jetë **numri personal i letërnjoftimit** tuaj.

2. Për të parë se cili është e-maili juaj, ju gjithashtu **mund të kyçeni në SMU** përmes linkut: **smu.aksp-ks.net**-> klikoni në logon e Profilit të Shfrytëzuesit (👤) -> Profili, pastaj do t'ju **shfaqen të dhënat e profilit**, ku ndër të tjera është edhe **e-maili juaj zyrtar i Fakultetit**.

Qasja në e-mail mund ta bëni përmes www.gmail.com, në fushën për "sign-in" shkruani **emri.mbiemri@aksp-ks.org** ndërsa në fushën: "Enter your password" shkruani passwordin tuaj (në këtë rast numrin personal të letërnjoftimit tuaj).

Ligjëratat do të mbahen sipas orarit që do të bëhet publik në web faqen e AKSP-së dhe po ashtu **do të njoftoheni nga profesori përkatës**.

Në rast të **problemeve me hapjen e e-mail-it** zyrtar shkruani në: dti.aksp@rks-gov.net;

Në rast se keni **probleme me SMU** shkruani në: dti.aksp@rks-gov.net;

I gjithë **stafi akademik dhe studentët** e Fakultetit për Siguri Publike janë të pajisur me **email zyrtar** në Google (Ilogaritë e krijuara mund ti testoni në www.gmail.com), prandaj **mund të bashkëveprojnë duke shfrytëzuar platformat** në vazhdim:

Google Meet <https://meet.google.com>

VIDEO rreth produktit: <https://www.youtube.com/watch?v=2jhTTzFMZkY>

Video konferencë, e cila mund të shfrytëzohet për krijimin e sesioneve dhe shpërndarjes

së kodit të sesionit, i cili ua mundëson studentëve të inkuadrohen në ligjëratën që po ligjërohet drejtpërdrejtë nga profesori.

Google Classroom <https://classroom.google.com>

VIDEO rreth

produktit: https://www.youtube.com/watch?v=Iw0T0uotAE8&list=PLP7Bvyb3ap44G3Gt_mTxO+HoCcIYTBlxg

Krijimi i klasave në të cilat mund të regjistrohen studentët, të shpërndahen detyrat e shtëpisë, materialet mësimore dhe vlerësohen punimet. Është një platformë shumë funksionale e ndërveprimit profesor-studentë.

Google Drive <https://drive.google.com/>

Video: <https://www.youtube.com/watch?v=pgdwQJqybQc>

Shpërndarja e materialeve për studentë. Pasi të vendosen materialet, ato mund të shpërndahen përmes linkut, pastaj nëpërmjet e-mailit, rrjeteve sociale, apo metodave të tjera të komunikimit.

SMU->Ngarko materiale mësimore për mësimdhënës.

SMU-> Shkarko materiale mesimore për student.

Mësimdhënësit kanë mundësi të ngarkojnë materialet mësimore për lëndë të caktuar përmes platformes SMU.

Rekomandojmë:

- **Google Meet** – për mbajtjen e ligjëratave.
- **Google Classroom** - për shpërndarjen e detyrave dhe materialeve.
- **SMU** për shpërndarje të materialeve mësimore.

Divizioni i Teknologjisë Informativë është i gatshëm të ofrojë mbështetje gjatë gjithë kohës për të evituar çfarëdo problemi që mund të ju shfaqet gjatë shfrytëzimit të shërbimeve elektronike.

Me respekt

Drejtori i Përgjithshëm

Ismail Smakiqi

Dekani i FSP

Bejtush Gashi

Akademia e Kosovës për Siguri Publike